



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI**

VENDIM

Nr. 133, Datë 07.07.2025

MBI

**DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË KONTRATËN TIP “PËR SHIT - BLERJEN E
ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK,
AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA
SHTETI, (KESH SH.A.) DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SH.A.,
PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE QË FURNIZOHEN NGA FSHU SH.A.”**

Në zbatim të neneve 16, 20 gërma “h”, 47, 56, gërma “f”, si dhe 62 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; Pjesës I, nenit 5, pika 4 të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 456, datë 29.06.2022 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike” i ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 07.07.2024, pasi shqyrtoi relacionin me nr. 1635/1 prot., datë 30.06.2025 “Mbi disa shtesa dhe ndryshime në kontratën tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, KESH sh.a. dhe furnizuesi i shërbimit universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 95, datë 20.05.2024, ka miratuar kontratën Tip për shit-blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë publike të prodhimit (KESH) sh.a. dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal (FSHU) sh.a.

1. Kërkesa për rishikimin e kontratës Tip

- Palët respektivisht KESH sh.a. me shkresën e përbashkët me nr. 1990/2 prot., datë 28.04.2025, dhe të FSHU sh.a. me nr. 2217/2 prot., datë 28.04.2024, kanë dërguar në ERE kërkesën për miratimin e kontratës për shit - blerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe FSHU sh.a., për vitin 2025, protokolluar me tonën nr. 1635, datë 28.04.2025.
- Kontrata e propozuar për vitin 2025 ruan të pandryshuara strukturën dhe kushtet thelbësore të kontratës Tip, duke reflektuar vetëm ndryshime përditësuese në bazën ligjore dhe rregullatore,

si dhe saktësime teknike që kanë dalë si rrjedhojë e hapjes graduale të tregut sipas Urdhrit të Ministrit nr. 322, datë 30.12.2024.

2. Përmbajtja e Ndryshimeve të Kontratës

Në bazën ligjore të kontratës:

- Vendimi i Bordit të ERE nr. 347, datë 27.12.2022, bëhet me shënimin "i ndryshuar" pas miratimit të ndryshimeve me vendimin nr. 265, datë 10.12.2024.
- Vendimi për rinovimin e licencës së FSHU sh.a. ndryshon nga nr. 164/2019 në nr. 162, datë 15.08.2024.
- Urdhri i Ministrit përgjegjës për Energjinë propozohet të ndryshojë nga nr. 217/2023 në nr. 322/2024.

Përditësimi i formulimeve në tekst:

- **Neni 2, pika 2:** togfjalëshi "...klientëve universalë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tensionit 6 kV dhe klientët me status të veçantë të lidhur në nivel tensioni 10/20 kV nën shërbimin FMF"

Vlerësohet të bëhet: "...klientëve universalë të lidhur në rrjetin e shpërndarjes në nivelet e tensionit ___ kV dhe klientët me status të veçantë të lidhur në nivel tensioni ___ kV nën shërbimin FMF, sipas urdhrit përkatës të Ministrit Nr. ___, datë ___".

- **Neni 9, gërma "c", pika iii** togfjalëshi "Klientët e furnizuar në TM 6/10 dhe klientët 20 kV me status të veçantë".

Vlerësohet të bëhet: Klientët e furnizuar në TM ___ dhe klientët ___ kV me status të veçantë, sipas urdhrit përkatës të Ministrit Nr. ___, datë ___.

- **Neni 14, pika 2/a togfjalëshi** "...miratuar dhe me Vendimin Nr.34 datë 10.02.2025 të Entit Rregullator të Energjisë."

Vlerësohet të bëhet: "...vendimin përkatës të Bordit të ERE-s.

- **Neni 14, pika 2/b togfjalëshi:** "...për klientët e furnizuar në TM 6 kV dhe 10/20 kV, me status të veçantë..."

Vlerësohet të bëhet: Klientët e furnizuar në TM ___ dhe klientët ___ kV me status të veçantë, sipas urdhrit përkatës të Ministrit Nr. ___, datë ___".

- **Neni 3, pika 1 i Aneksit II bëhet:** togfjalëshi "...në nivelet e tensionit 6 dhe 10/20 kV me status të veçantë..."

Vlerësohet të bëhet: "...klientët e lidhur në nivelet e tensionit ___ kV dhe ___ kV me status të veçantë, sipas urdhrit përkatës të Ministrit Nr. ___, Datë ___, në përputhje me dispozitat e akteve..."

3. Konsultimi Publik dhe qëndrimet e palëve

- Në kuadër të konsultimit publik ERE ka publikuar kontratën e depozituar në rubrikën konsultime më datë 21.05.2025.

- Shoqëria “GEN-I Tirana” sh.p.k. me shkresën nr. 09/2025-ER, datë 10.06.2025, pjesëmarrëse në tregun shqiptar të energjisë, ka paraqitur një qëndrim të detajuar mbi sfidat strukturore të tregut të energjisë në Shqipëri.
- Shqetësimet e paraqitura nga GEN-I Tirana janë me natyrë strategjike dhe afatgjatë, ato nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në përmbajtjen apo vlefshmërinë e kontratës për vitin 2025. Vlerësojmë se kontrata aktuale mbetet e nevojshme për garantimin e furnizimit në përputhje me detyrimet ligjore ekzistuese.

4. Vlerësimi dhe detyrimet për rishikimin e kontratës

- Në bazë të nenit 20, gërma “h” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Palët kanë përcjellë nëpërmjet shkresës së përbashkët nr. 1990/2 prot., datë 28.04.2025 të KESH sh.a. dhe nr. 2217/2 prot., datë 28.04.2025 të FSHU sh.a., protokolluar me nr. 1635 prot., datë 28.04.2025 në ERE, kontratën Tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. për furnizimin e klientëve universalë për periudhën 01/01/2025 – 31/12/2025; vlerësojmë që periudha duhet të shënohet në formën: dd/mm/vvvv – dd/mm/vvvv.
- Në bazën ligjore, vendimi i Ministrit përgjegjës për Energjinë, vlerësojmë që nr. prot. dhe data të vendosen në formën: nr. __ prot., datë dd/mm/vvvv.
- Në nenin 1 “Qëllimi i kontratës”, periudha kohore të shënohet: dd/mm/vvvv – dd/mm/vvvv.
- Në nenin 2, pika 3, të shënohet: “Çmimi i shitjes së energjisë elektrike për vitin [vvvv] është ai i miratuar me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shitësit nr. __ prot., datë dd/mm/vvvv”.
- Neni 12 të shënohet: “Kontrata është e vlefshme për periudhën dd/mm/vvvv – dd/mm/vvvv”.
- Neni 18 të rishkruhet pa përfshirë emrat e personave të kontaktit.
- Neni 21, pika 1, të rishkruhet duke hequr periudhën kohore dhe zëvendësuar me: “Kjo kontratë i shtrin efektet për periudhën dd/mm/vvvv – dd/mm/vvvv”.
- Në emërtimin e Aneksit nr. 1, viti 2025 të zëvendësohet me: [vvvv].
- Në emërtimin e Aneksit nr. 2, periudha kohore 01.01.2025 – 31.12.2025 të zëvendësohet me: dd/mm/vvvv – dd/mm/vvvv.
- Në nenin 1, pika 1.1 të Aneksit nr. 2, periudha kohore të zëvendësohet me: dd/mm/vvvv – dd/mm/vvvv.
- Në shtojcën nr. 1, viti 2025 të zëvendësohet me: [vvvv].
- Duke qenë se bordi i ERE-s ka miratuar kontratën Tip me vendimin nr. 95/2024, e cila përbën modelin referues të marrëdhënieve kontraktore për detyrimin e shërbimit publik dhe nuk ka afat të përcaktuar kohor, shoqërive KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. u lind detyrimi të përditësojnë në ERE kontratën konkrete të nënshkruar mbi bazën e kësaj kontrate Tip, pa kufizim kohor.
- Gjithashtu, vlerësohet se në Kontratën Tip, të miratuar me vendimin nr. 95, datë 20.05.2024, të bordit të ERE-s, referencat në bazën ligjore ndaj vendimit nr. 23, datë 25.03.2009, të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë dhe vendimit nr. 271, datë 19.09.2023, të Bordit të ERE-s “Mbi rinovimin e licencës...”, të zëvendësohen me vendimin nr. __, datë __, të Bordit të ERE-s.

- Për sa më sipër, në kuadër të Kontratës Tip dhe ndryshimit të propozuar në nenet 2, pika 2, 9, pika 2, c. 1, 14, pika 2, gërma “b” dhe 3, pika 1 e Aneksit II, togfjalëshi i propozuar nga KESH dhe FSHU për zëvendësimin e klientëve të lidhur në nivelet e tensionit 6 kV dhe klientët me status të veçantë të lidhur në tensionin 10/20 kV, në kuadër të kontratës TIP vlerësohet që formulimi të lihet: të lidhur në nivelet e tensionit ____ kV dhe klientët me status të veçantë të lidhur në tensionin ____ kV, sipas urdhrit përkatës së Ministrit Nr. __, Datë ____”.
- Në këtë kuadër, KESH sh.a. dhe FSHU sh.a. vlerësojnë se duhet të lidhin ndërmjet tyre kontratën, sipas modelit Tip të miratuar me vendimin nr. 95, datë 20.05.2024, duke përfshirë të gjithë elementët e përditësuar të marrëveshjes, pa përcaktuar një afat kohor specifik për përmbushjen e këtij detyrimi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të miratojë shtesat dhe ndryshimet e propozuara në kontratën TIP “Për shit - blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, (KESH sh.a.) dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.” (sipas tabelës bashkëlidhur).
2. Depozitim në ERE të kontratës së nënshkruar midis palëve “Për shit - blerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike të ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti, (KESH sh.a.) dhe Furnizuesi i Shërbimit Universal (FSHU) sh.a., për furnizimin e klientëve që furnizohen nga FSHU sh.a.” për vitet në vijim, për sa kohë kërkohet nga aktet ligjore në fuqi.
3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë shoqëritë, KESH s.a., FSHU sh.a., dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI

NDRYSHIMET E MIRATUARA NË KONTRATËS TIP “PËR SHIT - BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK, AKSIONET E SË CILËS KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE PJESËRISHT NGA SHTETI, (KESH SH.A.) DHE FURNIZUESI I SHËRBIMIT UNIVERSAL (FSHU) SH.A., PËR FURNIZIMIN E KLIENTËVE QË FURNIZOHEN NGA FSHU SH.A.

<i>Ndryshon dhe bëhet</i>	Baza ligjore	Ishte: Vendimi i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 347, datë 27.12.2022 “Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit dhe e Klerimit dhe e Shlyerjes)”. Bëhet: Vendimi i Bordit të Entit Rregullator të Energjisë nr. 347, datë 27.12.2022 “Për miratimin e Rregullave të Tregut të Energjisë Elektrike (Rregullat e ALPEX, Përkufizimet, Procedura e Tregtimit dhe e Klerimit dhe e Shlyerjes)”, i ndryshuar.
<i>Ndryshon dhe bëhet</i>	Baza ligjore	Ishte: Vendimi nr. 164, datë 04.11.2019 i Bordit të ERE-s “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”. Bëhet: Vendimi nr. 162, datë 15.08.2024 i Bordit të ERE-s “Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë Furnizuesi i Shërbimit Universal sh.a. (FSHU sh.a.) në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”;
<i>Ndryshon dhe bëhet</i>	Baza ligjore	Ishte: vendimi nr. 23, datë 25.03.2009, të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.. Bëhet: me vendimin nr. ___, datë ___, të Bordit të ERE-s.
<i>Ndryshon dhe bëhet</i>	Baza ligjore	Ishte: vendimi nr. 271, datë 19.09.2023, të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë.. Bëhet: me vendimin nr. ___, datë ___, të Bordit të ERE-s.
<i>Ndryshon dhe bëhet</i>	Baza ligjore	Ishte: Urdhër nr. 217, datë 29.12.2023 i Ministrisë përgjegjëse për Energjinë “Për një ndryshim në urdhrin nr. 28, datë 18.01.2021 ‘Për miratimin e

		udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike’, i ndryshuar”. Bëhet: Urdhër nr. 322, datë 30.12.2024 i Ministrit përgjegjës për Energjinë “Për disa ndryshime në urdhrin nr. 28, datë 18.01.2021 ‘Për miratimin e udhërrëfyesit për hapjen e tregut dhe derregullimin e çmimit të energjisë elektrike’, i ndryshuar”.
<i>Ndryshon dhe bëhet</i>	Neni 2, pika 2	Ishte: togfjalëshi “...në nivelet e tensionit 6/10 kV dhe klientët me status të veçantë të lidhur në tensionin 20 kV...” Bëhet “...në nivelet e tensionit __ kV dhe klientët me status të veçantë të lidhur në tensionin __ kV, sipas urdhrin përkatës të Ministrit Nr. __, Datë __...”.
<i>Ndryshon dhe bëhet</i>	Neni 9, gërma “c”, pika iii	Ishte: togfjalëshi “Klientët e furnizuar në TM 6/10 dhe klientët 20 kV me status të veçantë” Bëhet: Klientët e furnizuar në TM __ dhe klientët __ kV me status të veçantë, sipas urdhrin përkatës të Ministrit Nr. __, Datë __.
<i>Ndryshon dhe bëhet</i>	Neni 14, pika 2/a	Ishte: “...Vendimi nr. 46, datë 02.04.2024 të Entit Rregullator të Energjisë”. Bëhet: “...vendimin përkatës të Bordit të ERE-s.”.
<i>Ndryshon dhe bëhet</i>	Neni 14, pika 2/b	Ishte: Klientët e furnizuar në TM 6/10 dhe klientët 20 kV me status të veçantë. Bëhet: Klientët e furnizuar në TM __ dhe klientët __ kV me status të veçantë, sipas urdhrin përkatës të Ministrit Nr. __, Datë __...”.
<i>Ndryshon dhe bëhet</i>	Neni 3, pika 1 i Aneksit II	Ishte: togfjalëshi “...në nivelet e tensionit 6/10 kV dhe 20 kV me status të veçantë...” Bëhet: togfjalëshi “...në nivelet e tensionit __ dhe __ kV me status të veçantë, sipas urdhrin përkatës të Ministrit Nr. __, Datë __...”.